



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.305/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret : Skender Çoçaj kryesuese, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV, me seli në Prishtinë, kundër Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, A.nr.305/2025 A.nr.306/2025, A.nr.314/2025, A.nr.316/2025, A.nr.319/2025 A.nr.320/2025 dhe A.nr.323/2025 e datës 02.02.2025, e parashtruar kundër Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 02.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuara me numër A.nr.305/2025, A.nr.306/2025, A.nr.314/2025, A.nr.316/2025, A.nr.319/25 A.nr.320/2025 dhe A.nr.323/2025 te datës 02.02.2025, të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet, me seli në Prishtinë.

Në ankesën A.nr.305/2025 dhe A.nr.320/2025 subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë pretendon se më 02 shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, kanë vërejtur se në tubimin politik në kuadër të fushatës zgjedhore të organizuar nga Koalicioni AAK-Nisma, në qytetin e Klinës, tubim ky i mbajtur më datë 01.02.2025, nga kandidati për deputet nga radhët e këtij koalicioni z. Fatmir Limaj është përdorur gjuhë fyese ndaj kryeministrit Kurti, ku i njëjti tenton ta portretizoj z. Albin Kurtin (kandidatin nga radhët e tyre për kryeministër) si nxitës, përçarës, shpifës e mashtrues dhe, ka cituar: "Klina, Dukagjini

e Kosova duhet me i thanë jo shpifjes, përçarjes e mashtrimit", Klina e Kosova duhet me i thanë jo atyre që tentojnë me e përmbys historinë, me e shtrembëru historinë, "ata që për 4 vjet ju mashtruan, ata që për 4 vjet nuk bënë asgjë për vendin", "ata edhe në këtë fushatë na dëshmuar se e bënë atë që dijnë ta bëjnë më së miri të shpifin shajnë, akuzojnë e mashtrojnë si dhe në tubimin e mbajtur në Komunën e Vitisë nga i njëjti është përdorur gjuhë fyese ndaj kryeministrit Kurti, ku i njëjti tenton ta portretizoj z.Albin Kurtin (kandidatin nga radhët e subjektit të tyre për kryeministër) si nxitës, përçarës, shpifës e mashtrues dhe ndarës i kombit, dhe citoi: "ai e ndan kombin", "vjen ktu shpif e përçan, mashtron.

Në ankesën A.nr. 306/2025, pretendohet se aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, në rrjetin social facebook dhe TikTok kanë vërejtur një video të shkëputur nga emisioni "Konfront" në Koha Vision, nga faqja zyrtare e tyre në këtë rrjet social, në të cilën kandidati nga radhët e AAK-së, për deputet, z. Haki Abazi ka përdorur gjuhë të rëndë fyese dhe ofenduese, në kundërshtim flagrant me dispozitat e nenit 34 të LZP-së. Më tutje në ankesë theksojnë se Haki Abazi, kandidati i AAK-së, për deputetë përveç se e quan si jo të denjë për profesionin që ushtron kandidati Vigan Qorrolli, të njëjtin tenton ta nënçmoj para një numri të madh shikuesve audiovizuel që përcjellin emisionet televizive, duke thënë, citimi • "Ja ka bajt çantën Hajredin Kuçit" duke etiketuar si punë nënçmuese, jo të denjë dhe denigruese punën si Këshilltar i Ministrit në kohën sa ka qenë këshilltar i z. Kuçi. Sipas parashtruesit të ankesës konsiderojnë se etiketime të tilla përveç se fyejnë rëndë personalitetin e njeriut, dëmtojnë reputacionin e tij duke ditur shikueshmërinë e madhe të këtij emisioni, këto etiketime mund të krijojnë efektin e perceptimit negativ të një kandidati apo subjekt kundërshtar politik, pasi që nga Haki Abazi fyhet jo vetëm Vigan Qorrolli por çdo person që ushtron profesionin e këshilltarit.

Në ankesën A.nr. 314/2025, pretendohet se aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, kanë vërejtur se në tubimin politik në kuadër të fushatës zgjedhore të organizuar nga Koalicioni AAK-Nisma, në qytetin e Vitisë, tubim ky i mbajtur me datë 01.02.2025, nga kandidati për deputet nga radhët e këtij koalicioni z. Ramush Haradinaj është përdorur gjuhë fyese ndaj kryeministrit Kurti, ku i njëjti tenton ta portretizoj z .Albin Kurtin (kandidatin nga radhët tona për kryeministër) si mashtrues, citoi: 'pagë minimale 500 euro tash po thotë edhe ky që po shkon MASHTRUESI". Në vazhdim theksojnë se kandidati në fjalë ka tejkalluar qëllimin e fushatës zgjedhore dhe duke mos komentuar premtimet por me ofendime nga më të rëndat i drejtohet kryeministrit z. Albin Kurti me fjalën Mashtrues.

Në ankesën A.nr.316/2025, pretendohet se aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, kanë vërejtur se në tubimin politik në kuadër të fushatës zgjedhore të organizuar nga Koalicioni AAK-Nisma, në qytetin e Vitisë, tubim ky i mbajtur me datë 01.02.2025, nga kandidati për deputet nga radhët e këtij koalicioni z. Fatmir Limaj është përdorur gjuhë ndaj subjektit që nxit urrejtje ndaj subjektit politik VETËVENDOSJE, i cili ka thënë : "Anamorava, përkatësisht Vitia është ofenduar e fyer" Në vazhdim të ankesës theksohet se në asnjë rast nuk kanë ndonjë deklaram nga kandidatët tanë se Anamorava e Vitia janë fyer këto 4 vjet, ndaj ftojnë koalicionin AAK- Nisma që të bashkëngjis në përgjigjen e saj në ankesë pretendimet e saj me prova relevante, në bazë të barrës së të provuarit (onus propani), për arsye se për në është e vështirë dhe do të merrte muaj të tërë dhe të bashkëngjisin prova ku subjekti tyre nuk ka ofenduar Anamoravën e as Vitinë.

Në ankesën A.nr.319/2025, pretendohet se aktivistët e aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, kanë vërejtur se në tubimin politik në kuadër të fushatës zgjedhore të organizuar nga Koalicioni AAK-Nisma, në qytetin e Vitisë, , tubim ky i mbajtur me datë 01.02.2025, nga kandidati për deputet nga radhët e këtij koalicioni z. Fatmir Limaj është përdorur gjuhë ndaj subjektit që nxit urrejtje ndaj subjektit politik VETËVENDOSJE, i cili ka thënë: "veteranët janë ofenduar për 4 vite, ju kanë mbyll dyert".

Në ankesën A.nr.323/2025, pretendohet se aktivistët e aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, kanë vërejtur se në tubimin politik në kuadër të fushatës zgjedhore të organizuar nga Koalicioni AAK-Nisma, në qytetin e Vitisë, tubim ky i mbajtur me datë 01.02.2025, nga kandidati për deputet nga radhët e këtij koalicioni z. Zenun Elezaj është përdorur gjuhë ndaj subjektit që nxit urrejtje ndaj subjektit të tyre politik ku i njëjti tenton ta portretizoj qeverinë ta ngjyros si plëngprishëse etj, duke e quajtur qeverinë si "bllokuese të projekteve dhe selektive në ndarjen e buxhetit", "mësimdhënësit janë lënë në baltë, çka për këto akuza nuk përmend asnjë fakt i cili do vërtetonte se nuk kemi të bëjmë me fakte të pa vërtetuara kështu duke dëmtuar reputacionin e Lëvizjes VETVËNDOSJE.

Ankesave ka bashkangjitur si provë CD dhe linkun:

<https://www.facebook.com/watch/?v=537211001972835&rdid=kzD9myR2xFgdqOzZ>

Parashtruesi i ankesave thekson se me këto veprime kandidati dhe Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet, me seli në Prishtinë, ka cenuar dispozitat përkatëse ligjore dhe rregullative, konkretisht nenin 34 par 1 nënpar 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet (LZP) sepse kjo gjuhë e përdorur nxit urrejtje ndaj subjektit politik LVV. Kërkojnë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Më datë 03.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet, me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigjet në ankesa të paraqitura me datë 03.02.2025 dhe 04.02.2025, subjekti politik Koalicioni AAK, NISMA dhe Konservatoret dhe Intelektualet, me seli në Prishtinë, ka kundërshtuar ankesat e parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje paraqitur kundër kandidatëve për deputet nga radhët e Koalicioni AAK, NISMA dhe Konservatoret dhe Intelektualet.

Lidhur me pretendimet ankimore ku theksohet se nga kandidati për deputet nga radhët e këtij koalicioni z. Fatmir Limaj është përdorur gjuhë fyese ndaj kryeministrit Kurti, në përgjigjen në ankesë theksohet se nga deklarimi i lartcekur i z. Limaj, gjatë tubimit të tij në Klinë, në asnjë moment nuk ka përdorur gjuhë e cila ndalohet apo sanksionohet me dispozitat e Nenit 34 të LZP-së., madje në asnjë moment përmes këtyre deklarimeve nuk nxitet dhunë apo fyerje ndaj të tjerëve. Më tutje theksojnë se bazuar nga deklarimi i mësipërm i z. Limaj dhe nga dispozitat lartcekura mund të përfundojnë se i gjithë deklarimi nga z. Limaj, ka qenë brenda kufijve të lirisë së shprehjes dhe për më tepër brenda kuadrit të një propaganda zgjedhore e cila sipas tyre është një nga parimet themelore dhe demokratike të fushatës zgjedhore e përcaktuar me dispozitat e Nenit 4, par1, nën paragrafi 1.5. Në përgjigjen e tyre koalicioni në fjalë thekson se PZAP ka një praktikë të unifikuar lidhur me përdorimin e fjalës

"mashtgues", pasi që me vendimin A.nr. 252/2025, të datës 01.02.2025, i është refuzuar ankesa Institutit Demokratik të Kosovës (KDI)

Më tutje në përgjigje në ankesë lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesën Anr.306/2025, kandidatit për deputet z.Haki Abazi, i Koalicioni AAK, NISMA dhe Konservatorët dhe Intelektualet, se i njëjti ka përdorur "gjuhë fyese dhe ofenduese", në drejtim të z. Vigan Qorrolli, theksojnë se fillimisht PZAP-i, duhet të shqyrtoj afatshmërinë e kësaj anese, pasi që z. Haki Abazi, ka qenë i ftuar me datë 31.01.2025 në emisionin "Konfront", në KTV, dhe sipas dispozitave të Nenit 39, par. 3 të LZP-së, ankesa duhet të dorëzohet 48 orë nga momenti i shkëljes së supozuar. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se lidhur me pretendimin se është përdorur gjuhë fyese dhe ofenduese nga ana e z. Haki Abazi, pretendime të këtilla nuk kanë bazë dhe nuk bien në kundërshtim me dispozitat e Nenit 34, par. 1, nënpar. 11 të LZP-së.

Në përgjigje në ankesë lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesën Anr.314/2025, kandidatin për deputet nga radhët e këtij koalicioni z. Ramush Haradinaj është përdorur gjuhë fyese ndaj kryeministrit Kurti, ku i njëjti tenton ta portretizoj z .Albin Kurtin dhe i njëjti gjatë fjalimit ka deklaruar se: "page minimale 500 euro tash po thotë edhe ky që po shkon mashtguesi „, theksojnë se PZAP ka një praktikë të unifikuar lidhur përdorimin e fjalës "mashtgues", pasi që me vendimin A.nr. 252/2025, të datës 01.02.2025, i është refuzuar ankesa Institutit Demokratik të Kosovës (KDI). Si dhe përgjigje në ankesë lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesën Anr.323/2025, kandidatit për deputet z. Zenun Elezaj është përdorur gjuhë ndaj subjektit që nxit urrejtje ndaj subjektit të tyre politik deklaratën e z. Elezaj, mund të përfundohet se e gjithë deklarata e z. Elezaj është bërë brenda kufijve të lirisë së shprehjes dhe, për më tepër, në kuadër të propagandës zgjedhore, e cila përbën një nga parimet themelore dhe demokratike të fushatës zgjedhore.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.305/2025, A.nr.306/2025, A.nr.314/2025, A.nr.316/2025, A.nr.319/25 A.nr.320/2025 dhe A.nr.323/2025 te datës 02.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.305/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV) kundër subjektit te njëjtë politik Koalicioni AAK-NISMA AAK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

-Ankesat janë te pabazuara.

Paneli, pas shikimit të (linkut) të publikuar në rrjetin social Facebook - video incizimit të ofruar si provë materiale, nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) e cila është publikuar nga kandidatet për deputet nga radhët e Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët dhe Intelektualet,

në tubimin e Koalicionit, të mbajtur me datë 01.02.2025 në Komunën e Klinës dhe Komunën

e Vitisë shihet se kandidati Ramush Haradinaj nga ky Koalicion, i ishte drejtuar elektoratit të tij duke përdorë fjalët 'pagë minimale 500 euro tash po thotë edhe ky që po shkon mashtruesi, si dhe nga kandidati Fatmir Limaj nga ai njëjti koalicion Klina e Kosova duhet me i thanë jo atyre që tentojnë me e përmbys historinë, me e shtrembërua historinë, ", "veteranët janë ofenduar për 4 vite, ju kanë mbyll dyert" si dhe nga kandidati i njëjtit koalicion Zenun Elezaj, "mësimdhënësit janë lënë në baltë, si dhe shprehje tjera të cituara si më lartë, për të gjitha të lartcekurat paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe urrejtëse, fyese dhe urrejtëse në raport me subjektet tjera politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Gjuha e tille-frazat të cilat janë përdorur nga kandidatet e lartcekur në tubimin e tyre elektorale konsiderohet se hynë në diskursin e zakonshëm që përdoret gjatë fushatës zgjedhore dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin në mënyrë shprehimore është paraparë se: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Andaj Paneli, bazuar në provat e ofruara ka ardhur në përfundim se gjatë mbajtjes së tubimit elektorale të mbajtur me datë 01.02.2025 në Komunën e Klinës dhe Vitisë, kandidatet për deputet nga radhët e Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët dhe Intelektualet, është vlerësuar se përdorimi i një gjuhe të tillë nuk bie në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së,

Nga arsyet e theksuara më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr. 305/2025 më datë 04.02.2025

**Kryesues i Panelit,
Skender Çoçaj**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.